

# **Kuvendi që (s')mund të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve**

*Analizë e shkurtër*

*Korrik 2019, Prishtinë*



|||||

## PËRMBAJTJA:

<b>1. Problemi .....</b>	<b>4</b>
<b>2. Shkaktarët për mbikëqyrje të ulët të zbatimit të ligjeve .....</b>	<b>5</b>
<b>2.1. Zbrazëtirat ligjore në Rregulloren e Punës së Kuvendit.....</b>	<b>5</b>
<b>2.2. Mungesa e metodologjisë së mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit .....</b>	<b>6</b>
<b>2.3. Mungesa e kapaciteteve dhe mos-shfrytëzimi i resurseve financiare të komisioneve .....</b>	<b>7</b>
<b>2.4. Mos-miratimi i raporteve të komisioneve për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit në seanca plenare si pasojë e mungesës së kuorumit .....</b>	<b>7</b>
<b>2.5. Injorimi i të gjeturave të komisionit nga ana e ekzekutivit .....</b>	<b>8</b>
<b>2.6. Neglizhenca e deputetëve.....</b>	<b>8</b>
<b>2.7. Volumi i punës në komisione.....</b>	<b>9</b>
<b>3. Konkluzione dhe rekomandime .....</b>	<b>10</b>

|||||



Situata nuk ka ndryshuar as deri në përfundim të sesionit pranveror të vitit 2019 (muaji korrik). Në fakt, Kuvendi është duke shfaqur tendenca të rënies drastike të performancës kur bëhet fjalë për monitorimin e zbatimit të ligjeve, siç është paraqitur në figurën vijuese:




Figura 1. Numri i ligjeve të mbikëqyrura nga Kuvendi i Kosovës në periudhën 2008-2019

## 2. Shkaktarët për mbikëqyrje të ulët të zbatimit të ligjeve

Bazuar në të gjeturat nga monitorimi i punës së legjislaturës së fundit, KDI vlerëson se performanca e ulët e Kuvendit në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve është kryesisht rezultat i disa faktorëve intern, mbi të cilët Kuvendi ka kontroll dhe ndikim. Gjithashtu janë konsideruar edhe opinionet e deputetëve, administratës së Kuvendit si dhe përfaqësuesve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që përcjellin dhe ndihmojnë punën e Kuvendit.

### 2.1. Zbrazëtirat ligjore në Rregulloren e Punës së Kuvendit

Sipas Rregullos së Kuvendit (Neni 73), secili komision parlamentar, brenda fushës së përgjegjësisë së tij, është i autorizuar t'a mbikëqyrë zbatimin e ligjit nga Qeveria, përkatësisht nga ministria që bie në fushëveprimtarinë e komisionit apo agjencitë e pavarura.

Megjithatë, kjo rregullore nuk parasheh një prag minimal se sa ligje do të duhej të monitoroheshin nga komisionet parlamentare gjatë vitit. Që nga 2008-ta, monitorimi i zbatimit të

ligjeve është ndërtuar mbi një praktikë e cila përcakton që çdo komision parlamentar, në planin e tij vjetor, të përzgjedhë së paku dy ligje për t'i monitoruar.<sup>5</sup>

Por, komisionet parlamentare sado që kanë në diskrecion të plotë organizimin e punës së tyre, në planet e tyre të punës vazhdojnë të mos i japin prioritet monitorimit të zbatimit të ligjeve. Komisionet kanë paraparë në planet e punës të shqyrtojnë 116 projektligje gjatë vitit 2019, e sa i përket pjesës së mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, kanë përzgjedhur 23 ligje për t'i monitoruar se si dhe sa po zbatohen.

Edhe më shqetësues është fakti që Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka miratuar Planin e Punës për vitin 2019, andaj rrjedhimisht nuk ka mundësi as të kontrollojë se sa efektive janë komisionet parlamentare në përmbushjen e planeve të tyre të punës.

Kuvendi duhet t'a zbatoj në tërësi Rregulloren e Punës, duke miratuar Planin e Veprimit për Integrim Evropian, ku si shtyllë kryesore e këtyre veprimeve do të ishte edhe monitorimi i zbatimit të ligjeve. Kësisoj, deputetët do të obligoheshin të merrnin parasysht rekomandimet e identifikuar nga Raporti i KE-së për Kosovën, e që ky raport në vazhdimësi trajton mos efikasitetin e Kuvendit në monitorim të ligjeve.

KDI-ja vlerëson se shpërndarja e funksioneve parlamentare në planet e punës së komisioneve duhet të balancohet dhe sanksionohet më mirë për të adresuar mangësitë që Kuvendi ka në mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve. Kjo nënkupton që mbikëqyrja efektive e zbatimit të ligjit duhet të bëhet prioritet i ligjvënësve.

## 2.2. Mungesa e metodologjisë së mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit

Kuvendi i Kosovës ende nuk ka arritur të instalojë një metodologji konkrete të monitorimit të zbatimit të ligjeve. Shumica e komisioneve e vetë-adoptojnë metodologjinë e monitorimit të zbatimit të ligjeve, kryesisht duke aplikuar teknika siç janë realizimi i vizitave në terren apo duke ftuar në raportim përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjeve të caktuara.

Vizitat e punës të realizuara në institucionet përgjegjëse janë jo mirë të planifikuara dhe pa ide të qarta se çka mëtohet të arrihet nga to.

Përkundër faktit që KDI-ja dhe organizata tjera vendore e ndërkombëtare<sup>6</sup> në vazhdimësi kanë ofruar përkrahje për komisionet parlamentare në monitorimin e zbatimit të ligjeve apo përpilimin e parimeve dhe doracakëve për monitorim, komisionet ende nuk kanë arritur të pavarësohen në këtë drejtim dhe të standardizojnë procedurat për monitorim të zbatimit të ligjeve.

<sup>5</sup> "Roli i Kuvendit në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve", KDI, 2013.

<sup>6</sup> NDI, WFD, D+, INDEP etj.











|||||

Komisionet parlamentare nuk kanë konsistencë në kërkim të llogarisë nga dikasteret qeveritare lidhur me zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet për mbikëqyrjen e ligjeve të caktuara. Komisionet parlamentare në mënyrë të vazhdueshme ankohen për mungesën e informatave dhe llogaridhënies së ministrive lidhur me shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve që japin.

Deputetët e mandatuar në grupe punuese për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve e shohin si “jo atraktive” dhe pa benefit angazhimin e tyre në mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve, pasi sipas tyre ky aktivitet nuk u siguron vizibilitet në publik. Kjo qasje është indikative për mungesën e të kuptuarit të drejtë të mandatit dhe përgjegjësisë.

Kuvendi i Kosovës, përkatësisht komisionet parlamentare, edhe në rastet kur realizojnë mbikëqyrje, atë e bëjnë pa një udhëzues apo metodologji të qartë. Në rastet kur kanë nevojë për ekspertizë të jashtme, atë e shfrytëzojnë përmes asistencës së shoqërisë civile. Komisionet parlamentare, gjatë viteve 2018 dhe 2019, nuk e kanë shqyrtuar mundësinë e shfrytëzimit të fondeve që kanë në dispozicion, për të rritur performancën dhe efektshmërinë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Në mënyrë që të evitohen problemet e lartcekura, KDI-ja rekomandon si në vijim:

- Komisionet parlamentare, në planet e tyre të punës të shpërndajnë në mënyrë proporcionale funksionet dhe përgjegjësitë që lidhen me ligjbërjen dhe mbikëqyrjen, si dhe t’i rishikojnë praktikën e përcaktimit dhe përzgjedhjes së ligjeve për mbikëqyrje. Përsëritja e kritikave të Komisionit Evropian për Kosovën në raport me mbikëqyrjen e dobët në zbatimin e ligjeve të bëhet prioritet strategjik i Kuvendit dhe të adresohet sa më shpejtë;
- Kuvendi i Kosovës të adoptojë një metodologji të qëndrueshme dhe praktike me të cilën do të shërbeheshin komisionet parlamentare gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Kjo do të uniformonte dhe do t’i bënte më profesionale raportet e komisioneve parlamentare që lidhen me zbatimin e ligjeve;
- Kuvendi i Kosovës, në mënyrë të vazhdueshme duhet të kërkojë llogari dhe informata nga Qeveria lidhur me përmbushjen e rekomandimeve të dala nga raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Kjo nënkupton edhe përmirësimin e komunikimit me Qeverinë, në mënyrë që deputetët të jenë të informuar;
- Kuvendi i Kosovës duhet të marrë në konsideratë edhe sigurimin e ekspertizës së nevojshme për komisionet parlamentare në mënyrë që të realizohet mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve në formë adekuate. Kjo mund të bëhet duke shfrytëzuar fondet e alokuara nga Kryesia e Kuvendit për angazhim të ekspertëve të fushave ku mëtohet të realizohet monitorim i zbatimit të ligjeve;
- Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet t’i përmbushin obligimet dhe të kontribuojnë në mënyrë kualitative në grupet punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, duke mos e neglizhuar dhe zvarritur procesin;

|||||

|||||

- Kuvendi i Kosovës duhet t’i trajtojë me prioritet raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve të cilat po barten nëpër seanca, duke mos u votuar si pasojë e mungesës së kuorumit të deputetëve.

|||||